



3835
Nr. .Prot.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Rrogozhinë, më 22.09.2026

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë", njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Hënë datë 28.09.2026 ora 13:00⁰⁰, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.12, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 09.09.2026.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%".
- 4- Miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e Plan Masash 'Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret' ".
- 6- Miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e programit të transparencës së Bashkisë Rrogozhinë".
- 7- Miratim i projekt - vendimit, "Për përlogaritjen e nivelit të pagave për Bashkinë Rrogozhinë sipas vendimit Nr.103, datë 11.02.2026".
- 8- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e opinionit mbi propozimin për planin e ri tarifor për ujësjellësin Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës SH.A me Nr.3235.Prot datë 08.06.2026".
- 9- Miratim i projekt - vendimit, "Për subvencionimin e qirasë për strehimin e përkohshëm të familjeve, banesat e të cilave janë të rrezikuara nga rrëshqitja e tokës në fshatin Sterbeg, njësia administrative Kryevideh, bashkia Rrogozhinë".
- 10- Raport, mbi veprimtarinë e drejtorisë së Kadastrës dhe Menaxhimit të pronave për periudhën Mars- Korrik 2026.
- 11- Raport nga Administratorët e Njësive mbi punën e bërë përgjatë periudhës Janar-Maj 2026.
- 12- Njohje me shkresën "Kthim përgjigje", drejtuar kryetares së grupit të djathtë znj. Silvana Aliu nga drejtoria e Politikave Urbane.
- 13- Shqyrtim i kërkesës për informacion dhe ndërhyrje institucionale të anëtarit të këshillit bashkiak z. Mitat Daja.

Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

- Njohje me shkresat "Kthim përgjigje" drejtuar Këshilltarit z. Mitat Daja nga administrata e bashkisë si më poshtë :
 - Kthim përgjigje drejtuar këshilltarit z. Mitat Daja në cilësinë e kryetarit të komisionit të përkohshëm për verifikimin e procesit të rindërtimit, shkresa me Nr.628/2.Prot datë 11.06.2026.
 - Kthim përgjigje nga drejtoria e shërbimeve mbështetëse shkresa me Nr.1901/4.Prot datë 17.06.2026.
 - Kthim përgjigje nga drejtoria e bujqësisë, shkresa me Nr.1901/2.Prot datë 16.06.2026.
 - Kthim përgjigje nga drejtoria e financës shkresa me Nr.628/3.Prot datë 17.06.2026
 - Kthim përgjigje nga drejtoria e financës shkresa me Nr.1901/3.Prot datë 17.06.2026.
- 14- Informacion mbi evidentimin e problematikave në Institucionet Arsimore dhe marrjen e masave për rregullimin e tyre për të pasur kushte sa më optimale për vitin e ri shkollor 2026-2027.
- 15-Informacion mbi punën e bërë nga sektori i pyjeve dhe përmirësimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.
- 16-Informacion nga drejtoria e Bujqësisë mbi masat e marra mbi sistemin e kullimit dhe vaditjes në bashkinë Rrogozhinë.
- 17- Të ndryshme.

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mbledhet ditën e Premte datë 25.09.2026 ora 10 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla -Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.

Shënim :

- Pikat 4,5,6,7,8,10,11,12,13 dhe 14 shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjet paraardhëse të KB.
- Cilido komision tjetër që e konsideron të arsyeshme për t'u mbledhur dhe për të shqyrtuar një apo disa pika të rendit të ditës është i lutur të kordinojë me Sekretarin e Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI



Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al